



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë së Lirisë

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2026

K Ë R K E S Ë

KËRKUES:

39 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, anëtarë të Grupeve Parlamentare të Partisë së Lirisë dhe Partisë Demokratike.

OBJEKTI:

Krijimi i Komisioni Hetimor të Kuvendit, për kontrollin e ligjshmërisë, përgjegjshmërisë dhe efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve shtetërore lidhur me parandalimin, kontrollin, zbulimin dhe trajtimin e veprimtarive të dyshuara të trafikut ndërkombëtar të armëve

BAZA LIGJORE:

Nenet 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës së Shqipërisë;
Neni 25 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë;
Ligji Nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvend”, i ndryshuar.

DREJTUAR:

Z. Niko Peleshi

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Z. Kryetar i Kuvendit,

Ne, deputetët nënshkrues të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, si dhe ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, të ndryshuar dhe të zbatueshëm, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese për të drejtën e kontrollit parlamentar dhe ngritjen e komisioneve hetimore, paraqesim kërkesën për ngritjen e një Komisioni

Hetimor Parlamentar, me objektin, qëllimin, fushën dhe çështjet konkrete të përcaktuara më poshtë:

I. ÇËSHTJA E VEÇANTË QË PËRBËN OBJEKTIN E HETIMIT

Çështja e veçantë që propozohet t'i nënshtrohet hetimit parlamentar është verifikimi i veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve shtetërore të Republikës së Shqipërisë në lidhje me parandalimin, kontrollin, zbulimin, autorizimin, mbikëqyrjen dhe trajtimin institucional të veprimtarive të dyshuara të trafikut ndërkombëtar të armëve, të bëra publike më 7 shtator 2026 përmes deklarimeve dhe materialeve audio të publikuara nga ish-Zv/Kryeministri, Z. Arben Ahmetaj, si dhe verifikimi i çdo përgjegjësie politike, administrative ose institucionale që mund të rezultojë nga këto fakte.

Hetimi do të fokusohet veçanërisht në:

- a) mënyrën se si institucionet shtetërore kanë ushtruar kompetencat e tyre në fushën e kontrollit të armëve, municioneve dhe pajisjeve ushtarake;
- b) nëse institucionet kompetente kanë pasur dijeni, indicie, informacion ose sinjalizime lidhur me veprimtari të dyshuara të trafikut ndërkombëtar të armëve që lidhen me territorin, subjektet ose strukturat shqiptare;
- c) nëse janë marrë masat ligjore dhe institucionale të nevojshme për parandalimin, identifikimin, kontrollin dhe raportimin e këtyre veprimtarive;
- ç) nëse procedurat e importit, eksportit, tranzitit, transportit, magazinimit, paketimit, përpunimit ose transferimit të armëve dhe pajisjeve ushtarake janë zhvilluar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë;
- d) nëse subjekte private që kanë marrëdhënie kontraktore, administrative, licencuese ose të tjera me shtetin shqiptar kanë qenë të përfshira në veprimtari që kërkonin kontroll ose mbikëqyrje të posaçme nga autoritetet publike;

dh) nëse ndonjë institucion shtetëror, zyrtar publik ose strukturë publike ka lehtësuar, toleruar, moskontrolluar, mosraportuar ose penguar verifikimin e veprimtarive të dyshuara;

e) nëse mekanizmat shtetërorë të kontrollit kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe në përputhje me ligjin;

ë) nëse ka pasur përdorim, keqpërdorim ose përfshirje të pasurive, strukturave, licencave, autorizimeve, dokumentacionit apo kapaciteteve shtetërore në funksion të veprimtarive të dyshuara;

f) nëse nga faktet e administruara rezultojnë përgjegjësi politike, administrative ose institucionale.

II. TË DHËNAT DHE INDICET QË JUSTIFIKOJNË HETIMIN PARLAMENTAR

Shkaku konkret dhe i drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij hetimi parlamentar përbëhet nga deklaratimet dhe materialet audio të bëra publike më 7 shtator 2026 nga z. Arben Ahmetaj.

Sipas raportimeve publike mbi materialet e publikuara, janë ngritur pretendime konkrete për ekzistencën e një veprimtarie të dyshuar të trafikut ndërkombëtar të armëve, përfshirjen e subjekteve private, përdorimin e territorit shqiptar dhe marrëdhënie të pretenduara me struktura apo funksionarë shtetërorë. Në këto raportime janë përmendur edhe pretendime për transport dhe qarkullim të armëve përmes Shqipërisë dhe lidhje me kompani që operojnë në sektorin e mbrojtjes.

Këto materiale dhe deklaratime nuk konsiderohen nga kërkuesit si fakte të provuara, por si të dhëna dhe indicie konkrete që justifikojnë ushtrimin e funksionit kushtetues të kontrollit parlamentar.

Pikërisht për këtë arsye, objekti i Komisionit nuk është të marrë të mirëqena akuzat e bëra publike, por t'i verifikojë ato nëpërmjet dokumenteve, dëshmimeve, të dhënave zyrtare dhe kontrollit të veprimtarisë së institucioneve shtetërore.

III. PERIUDHA E HETIMIT

Hetimi parlamentar do të mbulojë periudhën:

1 janar 2024 deri më 7 shtator 2026, pa përjashtuar shqyrtimin e fakteve ose dokumenteve të mëparshme kur ato rezultojnë të domosdoshme për të kuptuar dhe verifikuar çështjen objekt të hetimit.

Kjo periudhë përcaktohet me qëllim që hetimi të ketë kufij të qartë kohorë, duke shmangur një objekt të papërcaktuar ose të pakufizuar në kohë.

IV. OBJEKTIVAT KONKRETË TË HETIMIT

Komisioni do të ketë për detyrë të përcaktojë:

- 1. Nëse institucionet shtetërore kanë pasur dijeni ose indicie për veprimtari të dyshuara të trafikut ndërkombëtar të armëve të lidhura me territorin e Republikës së Shqipërisë.**
- 2. Nëse janë respektuar procedurat ligjore për importin, eksportin, tranzitin, transportin, magazinimin, transferimin dhe kontrollin e armëve dhe pajisjeve ushtarake.**
- 3. Nëse janë lëshuar licenca, autorizime, certifikata ose dokumente të tjera shtetërore në përputhje me ligjin.**
- 4. Nëse kontrollet doganore, kufitare, portuale, aeroportuale dhe institucionale kanë qenë efektive.**
- 5. Nëse strukturat përgjegjëse për sigurinë dhe mbrojtjen kanë ushtruar kompetencat e tyre në mënyrë të plotë dhe të ligjshme.**
- 6. Nëse ka pasur komunikime, ndërhyrje, urdhra ose orientime nga funksionarë publikë që kanë ndikuar në mënyrën e trajtimit institucional të çështjeve të dyshuara.**
- 7. Nëse subjektet private të përmendura në materialet publike kanë pasur marrëdhënie me institucione shtetërore dhe nëse këto marrëdhënie kanë qenë objekt i kontrollit të kërkuar nga ligji.**

8. Nëse ka pasur përdorim të pasurive, infrastrukturës, licencave, dokumentacionit ose kapaciteteve shtetërore në funksion të veprimtarive të dyshuara.
9. Nëse institucionet përgjegjëse kanë referuar pranë organeve kompetente të drejtësisë ose autoriteteve të tjera çdo informacion që, sipas ligjit, kërkonte referim ose verifikim.
10. Nëse mekanizmat institucionalë të kontrollit kanë funksionuar në mënyrë të pavarur, efektive dhe në përputhje me ligjin.
11. Nëse ekzistojnë mangësi ligjore, administrative ose institucionale që kanë mundësuar ose mund të mundësojnë veprimtari të paligjshme në fushën e tregtimit dhe qarkullimit ndërkombëtar të armëve.
12. Cilat masa ligjore, administrative dhe institucionale duhet të merren për të parandaluar përsëritjen e rasteve të ngjashme.

V. MATERIALI AUDIO I PUBLIKUAR MË 7 SHTATOR 2026

Komisioni do të administrojë, në përputhje me ligjin, materialet audio të bëra publike më 7 shtator 2026, si dhe çdo dokument shoqërues të vënë në dispozicion.

Në mënyrë të veçantë, Komisioni do të kërkojë verifikimin e:

- origjinës së materialeve;
- datës dhe rrethanave të regjistrimit;
- integritetit teknik të regjistrimeve;
- identitetit të personave që rezultojnë në regjistrime;
- përputhshmërisë së përmbajtjes së regjistrimeve me dokumentet zyrtare;
- ekzistencës së dokumenteve, kontratave, autorizimeve, transfertave, të dhënave doganore ose dokumenteve të transportit që mund të konfirmojnë ose kundërshtojnë pretendimet e bëra publike.

Komisioni nuk do të marrë përsipër të përcaktojë vetë përgjegjësi penale mbi bazën e materialeve audio, por do të verifikojë nëse këto materiale përputhen me faktet, dokumentet dhe veprimtarinë e institucioneve publike.

VI. INSTITUCIONET QË DO TË PËRFSHIHEN NË HETIMIN PARLAMENTAR

Në varësi të kompetencave konkrete, Komisioni do të kërkojë informacion, dokumentacion dhe dëshmi nga:

- Kryeministri, Z. Edi Rama
- Ministri i Mbrojtjes, Z. Ermal Nufi
- Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Lejtnant Arben Voke Kingji
- Drejtoresha e Shërbimit Informativ të Shtetit, Znj. Vlora Hyseni
- Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Z. Skënder Hita
- Drejtorin e Përgjithshëm të KAYO, Z. Ardi Velu
- institucionet dhe strukturat përgjegjëse për industrinë e mbrojtjes;
- strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe autorizimin e tregimit të armëve;
- administrata doganore;
- autoritetet portuale dhe aeroportuale;
- strukturat e kontrollit kufitar;
- institucionet përgjegjëse për licencimin dhe mbikëqyrjen;
- institucionet e tjera publike që rezultojnë të kenë kompetencë mbi çështjen;
- çdo subjekt tjetër publik ose privat, në masën që informacioni i tij lidhet drejtpërdrejt me objektin e hetimit.
- Z. Arben Ahmetaj, si personi që ka bërë publike materialet dhe pretendimet;

VII. DOKUMENTACIONI QË DO TË KËRKOHEJ

Komisioni do të kërkojë, ndër të tjera:

1. Licenca dhe autorizime për import, eksport, tranzit ose transferim armësh dhe pajisjesh ushtarake.
2. Dokumentacion doganor dhe transporti.
3. Dokumentacion lidhur me hyrjen dhe daljen e mallrave të kategorisë ushtarake nga territori shqiptar.
4. Kontrata ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private që lidhen me objektin e hetimit.
5. Vendime të organeve drejtuese të institucioneve dhe shoqërive shtetërore.

6. Korrespondencë zyrtare ndërinstytucionale.
7. Raporte kontrolli dhe inspektimi.
8. Të dhëna mbi autorizimet për përdorimin e objekteve, kapaciteteve ose infrastrukturës shtetërore.
9. Çdo informacion tjetër që lidhet drejtpërdrejt me objektin e hetimit.

Kur dokumentacioni përmban informacion të klasifikuar ose të mbrojtur me ligj, administrimi dhe trajtimi i tij do të kryhet në përputhje me legjislacionin përkatës.

VIII. DËGJIMET DHE ADMINISTRIMI I DËSHMIVE

Komisioni do të thërrasë për dëgjuesë, sipas nevojës dhe kompetencës:

- titullarët dhe ish-titullarët e institucioneve përgjegjëse;
- funksionarë publikë që kanë pasur kompetencë mbi çështjen;
- drejtues të strukturave shtetërore përkatëse;
- përfaqësues të subjekteve private të lidhura me objektin;
- ekspertë të fushës;
- çdo person tjetër që disponon të dhëna të drejtpërdrejta mbi çështjen.

Dëshmitarët do të pyeten vetëm mbi fakte, rrethana dhe veprime që lidhen me objektin e përcaktuar të hetimit.

IX. GARANTIMI I NDARJES DHE BALANCIMIT TË PUSHTETETEVE

Ky Komision Hetimor nuk synon dhe nuk mund të zëvendësojë funksionet e Prokurorisë, gjykatave, Policisë Gjyqësore apo të çdo organi tjetër kushtetues.

Objekti i hetimit parlamentar është kontrolli i veprimtarisë së institucioneve publike dhe efektivitetit të tyre në zbatimin e ligjit, si dhe përcaktimi i përgjegjësive politike dhe institucionale.

Në rast se një pjesë e fakteve objekt të hetimit është ose bëhet objekt i një procedimi penal, Komisioni do të shmangë çdo veprim që do të përbënte dublim ose zëvendësim

të hetimit penal dhe do ta kufizojë veprimtarinë e tij në aspektin e kontrollit parlamentar.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi jurisprudenca kushtetuese ka përcaktuar se ekzistenca e një hetimi penal nuk përbën vetvetiu pengesë për një hetim parlamentar, por Kuvendi duhet të respektojë kufijtë e kompetencave të organeve të tjera.

X. TRANSPARENCA E HETIMIT

Veprimtaria e Komisionit do të jetë, si rregull, publike.

Përjashtim do të bëhet vetëm kur kjo kërkohet për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit, informacionit të klasifikuar, sekretit hetimor, sekretit tregtar ose interesave të tjera të mbrojtura shprehimisht nga ligji.

Në çdo rast, kufizimi i transparencës do të jetë i arsyetuar, proporcional dhe i kufizuar vetëm në pjesën e nevojshme.

XI. RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Në përfundim të veprimtarisë së tij, Komisioni do t'i paraqesë Kuvendit raportin përfundimtar, i cili do të përmbajë:

- a) faktet e konstatuara;
- b) dokumentet dhe provat e administruara;
- c) vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve institucionale;
- ç) përgjegjësitë politike dhe institucionale që rezultojnë;
- d) mangësitë e identifikuara në kuadrin ligjor ose institucional;
- dh) rekomandimet për përmirësimin e legjislacionit dhe mekanizmave të kontrollit;

e) çdo çështje që, sipas ligjit, duhet t'u përcillet institucioneve kompetente.

XII. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE

Kjo kërkesë mbështetet në:

- nenin 7 të Kushtetutës, mbi ndarjen dhe balancimin e pushteteve;
- nenin 23 të Kushtetutës, mbi të drejtën e informimit;
- nenin 77 të Kushtetutës, mbi komisionet hetimore;
- nenin 78 të Kushtetutës, mbi organizimin dhe funksionimin e Kuvendit;
- ligjin nr. 8891, datë 02.05.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", të ndryshuar dhe të zbatueshëm;
- Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, veçanërisht nenin 25;
- jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese mbi natyrën, objektin, kufijtë dhe efektivitetin e hetimit parlamentar.

XIII. KËRKESA PËR NGRITJEN E KOMISIONIT

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të legjislacionit në fuqi, kërkojmë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

1. Të miratojë ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar me objektin e përcaktuar në këtë kërkesë.
2. Të përcaktojë në vendimin për ngritjen e Komisionit objektin, fushën e veprimit, detyrat, përbërjen dhe afatin e veprimtarisë së tij.
3. Të garantojë ushtrimin efektiv të të drejtës së pakicës parlamentare për kontroll dhe hetim.
4. Të garantojë që çdo çështje eventuale kushtetuese ose ligjore lidhur me formulimin e objektit të trajtohet përmes riformulimit ose formulimit alternativ, në përputhje me standardet e jurisprudencës kushtetuese, dhe jo përmes mohimit të së drejtës kushtetuese për ngritjen e Komisionit.

5. Të garantojë që Komisioni të ketë mundësi reale për administrimin e dokumenteve dhe dëshmive të nevojshme për realizimin efektiv të objektit të hetimit.

6. Të autorizojë Komisionin të kërkojë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm nga institucionet publike dhe subjektet e tjera, në përputhje me ligjin.

7. Të garantojë zhvillimin e hetimit në përputhje me parimin e transparencës, duke respektuar njëkohësisht informacionin e klasifikuar dhe të drejtat e personave të përfshirë.

8. Në përfundim, të shqyrtojë raportin e Komisionit dhe rekomandimet e tij.

XIV. KËRKESË PROCEDURALE

Në rast se gjatë shqyrtimit parlamentar vlerësohet se ndonjë pjesë e formulimit të propozuar të objektit nuk përputhet plotësisht me standardet kushtetuese, kërkojmë që kjo të mos sjellë rrëzimin e kërkesës në tërësi.

Në përputhje me të drejtën kushtetuese të pakicës parlamentare dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, kërkojmë që, nëse konsiderohet e nevojshme, të propozohet një formulim alternativ i kufizuar dhe kushtetues i objektit, duke ruajtur thelbin e çështjes së veçantë për të cilën kërkohet kontrolli parlamentar.

Kjo kërkesë bëhet me qëllim garantimin e efektivitetit të nenit 77 të Kushtetutës dhe shmangien e një refuzimi formal për arsye të formulimit.

XV. PËRFUNDIM

Pretendimet dhe materialet e bëra publike më 7 shtator 2026 kanë ngritur një çështje me rëndësi të veçantë publike dhe shtetërore lidhur me funksionimin e mekanizmave të kontrollit të shtetit shqiptar mbi qarkullimin ndërkombëtar të armëve.

Rëndësia e çështjes nuk qëndron në marrjen e mirëqenë të akuzave të bëra publike, por në nevojën për të përcaktuar, mbi bazën e dokumenteve dhe fakteve të verifikueshme

nëse institucionet shtetërore kanë përmbushur detyrimet e tyre ligjore dhe kushtetuese për parandalimin, kontrollin dhe zbulimin e veprimtarive të paligjshme të lidhura me trafikun ndërkombëtar të armëve.

Për shkak të natyrës së çështjes, implikimeve të mundshme për sigurinë kombëtare, integritetin institucional, kontrollin e kufijve dhe detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, vlerësojmë se ekzistojnë kushtet kushtetuese dhe ligjore për ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar.

Për sa më sipër, kërkojmë ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Grupi Parlamentar i Partisë së Lirisë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

